



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

UDHËZUES

PËR

**PROCEDURAT E APLIKIMIT, SHQYRTIMIT, VLERËSIMIT, MIRATIMIT DHE
MONITORIMIT TË PROJEKTEVE QË FINANCOHEN NË KUADËR TË PROGRAMEVE
KOMBËTARE PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM (PKKZH)**

Viti 2023

Tabela e përmbajtjes

KREU 1. PROCEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT FORMAL PROJEKTEVE NË KUADRIN E PROGRAMIT	3
1.1 Rreth Programit të PKKZH-ve	3
1.2 Qëllimi i Programit të PKKZH-ve	3
1.3 Objektivat e Programit PKKZH	3
1.4 Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve	3
KREU 2. PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE.	4
2.1 Shpallja e thirrjes për aplikimpër projekte.	4
2.2 Dokumentacioni i aplikimit	4
2.3 Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit	4
2.4 Shqyrtimi i dosjes së aplikimit	4
2.5 Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit	5
2.6 Njoftimi i fituesve	5
KREU 3. VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE	5
3.1 Procedurat e vlerësimit dhe miratimit të projekteve	5
3.2 Procesi i vlerësimit	5
3.3 Procedura e miratimit për financim të projekteve	5
KREU 4. ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E TYRE.	6
4.1 Financimi i projekteve fituese	6
4.2 Buxheti i detajuar (kostot e ndryshme)	6
4.3 Raportimi vjetor (për projektet me kohëzgjatje mbi një vit)	7
KREU 5. PROCEDURA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE	7
5.1 Qëllimi i monitorimit	7
5.2 Fazat e monitorimit	7
5.3 Detyrimet e aplikantit	7
5.4 Raportet e monitorimit	7
KREU 6. PARAQITJA E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR (STUDIM)	7
Struktura e raportit shkencor	7
6.2 Dokumente të tjera	8
KREU 7. ÇËSHTJE ETIKE	8
PLOTËSIMI I DOKUMENTIT TË PROJEKTIT	9

KREU 1. PROCEDURA E PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT FORMAL PROJEKTEVE NË KUADRIN E PROGRAMIT

1.1 Rreth Programit të PKKZH-ve

Programet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit janë paraqitje sintetike e aktiviteteve sistematike kërkimore dhe zhvillimore, që ndërmerren për të arritur objektiva të caktuara në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rendësi për përparimin e vendit. Programet Kombëtare zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe mbështesin në aspektin kërkimor dhe zhvillimor Programin e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit.

1.2 Qëllimi i Programit të PKKZH-ve

Qëllimi i programit është të mbështesë realizimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe inovacionit në IAL dhe institucione kërkimore shkencore. Mbështetja ofrohet për projekte që përputhen me fushat prioritare kombëtare dhe zhvillimet rajonale dhe europiane të kërkimit shkencor si dhe për projekte të mbështetura në marrëveshje bashkëpunimi të IAL-ve dhe institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit ndërmjet tyre, ndërmjet IAL-ve dhe sektorit të biznesit si dhe projekte që nxisin inovacionin;

1.3 Objektivat e Programit PKKZH

Objektivat e programit të PKKZH-ve janë:

Të mbështesë kërkimin shkencor dhe inovacionin në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale;

Të vendosë kërkimin shkencor në qendër të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit;

Të nxisë inovacionin dhe zhvillimin teknologjik nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë me komunitetin e biznesit;

Të nxisë bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor ndërmjet institucioneve vendore të kërkimit shkencor dhe partnerëve ndërkombëtarë;

1.4 Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve

Vendimi Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, në pikën 4 të tij përcakton se kanë të drejtë të aplikojnë për financim të projekteve në kuadër të PKKZH, Institucionet e Arsimit të Lartë të përcaktuara si të tilla në pikën 4, të Nenit 4, të Ligjit Nr. 80/2015 të sipërcituar si dhe dhe institucionet publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë për kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

KREU 2. PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE.

2.1 Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit me vendim të Bordit të Administrimit, shpall në faqen zyrtare të internetit thirrjen për aplikim për projekte. Gjithashtu MAS informon IAL mbi thirrjen e shpallur.

2.2 Dokumentacioni i aplikimit

Dokumentacioni për aplikim për projekte është hartuar nga AKKSHI dhe është i aksesueshëm nga të gjithë personat apo institucionet që janë të interesuar të aplikojnë në kuadrin e programit të PKKZH-ve, nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit. Paketa e dokumentave, siç janë forma e aplikimit, forma e propozimit financiar, etj janë pjesë të këtij udhëzuesit. Çdo aplikim dorëzohet nëpërmjet protokollit në AKKSHI i shoqëruar me shkresë zyrtare të institucionit që aplikon (Agjencia ekzekutuese) për projektin. Projekt- propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formës së Aplikimit të Projektit për Kërkim e Zhvillim (Aneks 1) dhe Formës së Propozimit Financiar (Aneks 2). Sqarimet për mënyrën e plotësimit të Dokumentit të Projektit për Kërkim dhe Zhvillim dhe të Formës së Propozimit Financiar gjenden në (Aneks 2/1).

2.3 Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit

Dosja e aplikimit për një projekt kërkim zhvillimi, duhet të depozitohet në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit brenda afatit të përcaktuar në Thirrjen për aplikim të shpallur nga AKKSHI.

Përcaktimi i afateve për depozitimin e aplikimit kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”. Llogaritja e afateve të depozitimit të dosjes së aplikimit pranë AKKSHI, kryhet në përputhje me përcaktimet e neneve 56 dhe 57 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Aplikuesi mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, në përputhje me nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.

2.4 Shqyrtimi i dosjes së aplikimit

Në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kontrolli formal bëhet në Drejtorinë e Programeve Kombëtare, në Sektorin e Programeve Kombëtare, që administron Projektet Kombëtare për Kërkim e Zhvillim. Ai synon të vlerësojë nëse projekt-propozimi është formuluar në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit¹ për të gjitha fushat prioritare.

Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacion të plot, kanë pasaktësi në plotësim, apo që nuk përmbushin kriteret dhe formatin e përcaktuar nga AKKSHI, skualifikohen.

¹ Strategjitë Kombëtare Sektoriale

2.5 Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit

Projektet të cilat i janë përmbajtur kritereve administrative të vendosura nga AKKSHI së bashku me dokumentacionin përkatës, kalojnë në procesin e vlerësimit teknik nga komisionet e vlerësimit të projekteve.

2.6 Njoftimi i fituesve

Pasi vlerësohen nga komisionet e ekspertëve të vlerësimit dhe pasi miratohen nga Bordi i Administrimit, projektet të cilat shpallen fituese njoftohen me shkresë zyrtare dhe gjithashtu shpallja e fituesve bëhet edhe në faqen zyrtare të internetit të AKKSHI.

KREU 3. VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE

3.1 Procedurat e vlerësimit dhe miratimit të projekteve

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të drejtimit të çdo aktiviteti shkencor. Atij i nënshtrohen të gjitha Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit.

Ai nevojitet për të evidentuar gjendjen reale të ecurisë së projekteve dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e saj, për të nxjerrë përfundime të drejta lidhur me vlerën e vetë projekteve, rezultatit shkencor të projektit, problemet administrative, financiare si dhe mësimet në lidhje me projektet e ardhshme.

3.2 Procesi i vlerësimit

Projekt-propozimi që kalon kontrollin formal e administrativ i jepet për ekspertizë Komisionit të Ekspertëve, që bën vlerësimin përmbajtësor e teknik të tij.

Komisioni i ekspertëve për kryerjen e vlerësimit përmbajtësor e teknik të projekt propozimeve, miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-t pas një procesi të hapur aplikimesh nga kandidatët. Pjestarë të tij zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse që nuk janë pjestarë të personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë.

Procesi i vlerësimit bëhet në përputhje me Skedën e Vlerësimit të Projekteve. (Aneks 3)

Komisioni i Ekspertëve përpara fillimit të procesit të vlerësimit, nënshkruan Deklaratën e Konfliktit të Interesit (Aneks 4).

Eksperti i vlerësimit shpërblehet për punën e kryer bazuar në VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”.

Në grupin e vlerësimit nuk përfshihen persona të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në aktet e hartimit, miratimit, zbatimit dhe drejtimit të projektit.

3.3 Procedura e miratimit për financim të projekteve

Procesi i miratimit për financim të projektit kalon përmes këtyre hapave:

- Marrja e Vendimit. Vlerësimet e Komisionit të Ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-me procesverbalin përkatës të mbajtur nga çdo komision (Aneks 7) dhe listën me renditjen e projekteve sipas mesatares të pikëve të firmosur nga ekspertët vlerësues (Aneks 8). Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI e paraqet listën për miratimin e projekteve fituese në Bordin e Administrimit.

- Lidhja e Kontratës. Nëse projekt-propozimi miratohet për financim nga Bordi i Administrimit, lidhet kontrata sipas modelit bashkëlidhur (Aneks 9) ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t dhe institucionit shkencor që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga drejtuesi i tij dhe drejtuesi i projektit

KREU 4. ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E TYRE.

4.1 Financimi i projekteve fituese

Pas vlerësimit nga ekspertët e komisioneve të vlerësimit dhe pas miratimit të projekteve fituese në Bordin e Administrimit, përfituesi do të marrë fondin e përcaktuar, brenda një afati jo më të gjatë se 45 ditë pas shpalljes së vendimit për financimin e projektit.

Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga Bordi i AKKSHI-së.

Zgjatja në kohë e projektit ndodh vetëm pas një kërkesë nga përfituesi e dërguar të paktën 7 (shtatë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së. AKKSHI-ja njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë së përfituesit.

Ndryshimet në zërat buxhetore lejohen deri në një total prej 10 % të fondit (brenda të njëjtit zë) të financuar nga AKKSHI-ja dhe mund të bëhen pa miratimin paraprak. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKKSHI-në duke argumentuar që ndryshimet e kërkuara nuk ndikojnë në cilësinë e realizimit të projektit dhe janë bërë në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

4.2 Buxheti i detajuar (kostot e ndryshme)

Pas miratimit për financim, drejtuesi i projektit risjell Planin e Financimit të detajuar të projektit sipas Ankes 10/3, 10/4.

Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit.

Pagesat e personelit të angazhuar në grupin e punës së projektit duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi¹. Numri i ditëve të punës për anëtarët e grupit të përfshirë në projekt nuk mund të kalojnë limitin prej 6 ditë punë/muaj.

Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, nuk duhet të lidhen me funksionimin e përgjithshëm të institucionit dhe duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:

1. Blerje e tokës.
2. Shit-blerje makinash.
3. Interes mbi huadhënie.
4. Marrëveshje huadhënie.
5. Dhurime.
6. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
7. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.

¹ Kodi i punës i RSH

8. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

4.3 Raportimi vjetor (për projektet me kohëzgjatje mbi njëvit)

Raporti vjetor bëhet për çdo projekt më vete dhe i paraqitet organit financues në dyjavorin e parë të muajit Janar të vitit në vazhdim. Raporti vjetor duhet të depozitohet në AKKSHI me shkresë përcjellëse së bashku me planin e financimit për vitin pasardhës. Në Raportin për realizimin e detyrave dhe financimit jepen një për një realizimi i detyrave dhe rezultatet e arritura, të shprehura në tregues sasiorë dhe cilësorë, detyrat e parashikuara që nuk janë realizuar dhe problemeve që mund të kenë dalë dhe realizimi i planit të financimit. Mënyra e paraqitjes së raportit vjetor do të jetë sipas Skemës në (Aneks 10).

KREU 5. PROCEDURA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE

5.1 Qëllimi i monitorimit

Procesi i monitorimit fokusohet në dy drejtime kryesore: a) në verifikimin e zbatimit të projektit sipas planifikimit të projektit të miratuar për financim, b) në shqyrtimin e raporteve të drejtuesve të projekteve mbi ecurinë e projekteve. AKKSHI nuk ka funksion të saj auditimin financiar të fondeve që ka përfituar institucioni i arsimit të lartë nga granti i infrastrukturës.

5.2 Fazat e monitorimit

Monitorimi i projekteve realizohet nga grupet e ngritura me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit çdo gjashtë muaj.

5.3 Detyrimet e aplikantit

Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për ekspertët monitorues të AKKSHI pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentet lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.

5.4 Raportet e monitorimit

Pas përfundimit të monitorimeve grupi i monitorimit harton raportin përkatës për çdo projekt të financuar nga AKKSHI.

Monitorimi sqaron çështjet sipas Skemës në (Aneks 11), mbi bazën e të cilës ndërtohet Raporti i Misionit të Monitorimit.

KREU 6. PARAQITJA E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR (STUDIM)

Në përfundim të çdo projekti për kërkim e zhvillim përpilohet raporti shkencor (studimi) përkatës. Ky raport, si dhe dokumente të tjera që përcaktohen në këtë udhëzim i paraqiten institucionit financues përgjegjës brenda afatit të parashikuar për përfundimin e projektit.

Struktura e raportit shkencor

Raporti shkencor (studimi) paraqitet sipas strukturës së mëposhtme (Aneks 12):

1. Kopertina sipas modelit bashkëlidhur.
2. Përmbajtja e lëndës, ku jepet emërtimi i kapitujve e nënkaptujve dhe numri i faqeve përkatëse.

3. Lista e shkurtimeve të termave të përdorura (Faqe më vete).
4. Lista e ilustrimeve (figura, grafikë, harta, skica, etj.) (Faqe më vete).
5. Hyrja.
6. Rezultatet shkencore të projektit.
7. Përfundime.
8. Rekomandime.
9. Literatura.

6.2 Dokumente të tjera

Bashkë me raportin shkencor (studimin) institucionit finacues i dërgohen dhe;

1. Situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas pasqyrave bashkëlidhur (Aneks 12/1, Aneks 12/2). Bëhen komentet e nevojshme.
2. Tabelë përmbledhëse me të dhëna për projektin e financuar (Aneks 12/3).
3. Vlerësimi i ekspertizës së bërë nga institucioni shkencor përgjegjës për projektin.
4. Vendimi i Këshillit Shkencor të institucionit shkencor përgjegjës.
5. Skeda informative sipas modelit bashkëlidhur (Aneks 12/4).

KREU 7. ÇËSHTJE ETIKE

Aplikantët duhet të deklarojnë se do të respektojnë parimet kryesore etike dhe përcaktimet e kuadrit ligjor kombëtar dhe europian lidhur me etikën në kërkimin shkencor, si më poshte vijon:

- Respektimi i dinjitetit dhe integritetit njerëzor
- Sigurimi i ndershmërisë dhe transparencës ndaj subjekteve kërkimore dhe veçanërisht marrja e pëlqimit dhe informimit
- Sigurimi i privatësisë dhe konfidencialitetit
- Promovimi i drejtësisë dhe i gjithëpërfshirjes
- Minimizimi i dëmit dhe përfitimi maksimal
- Respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe gjeneratave të ardhshme.

PLOTËSIMI I DOKUMENTIT TË PROJEKTIT

Forma e aplikimit

Plotësimi i saktë i dokumentit të projektit sipas kërkesave të Modelit të AKKSHI, ka rëndësi të veçantë, sepse mbi këtë document bazohet zgjedhja ose refuzimi i projekt-propozimit për financim. Në plotësimin e tij duhet të mbahet parasysh sa vijon:

- Pika 1 - Në krye të Dokumentit shënohet emri i plotë i institucionit (instituti, universiteti, fakulteti apo qendra shkencore, shtetërore apo private), që njihet si person juridik dhe që merr përsipër të gjitha detyrimet për realizimin në kohë e me cilësi të projektit (Agjencia Ekzekutuese). Shënohet, gjithashtu, nënndarja e saj (departamenti, sektori, kabineti, etj.) që do të realizojë apo do të drejtojë projektin.

Projekt-propozimi duhet të paraqitet vetëm në një nga 6 fushat prioritare siç janë specifikuar në Thirrjen për aplikim të AKKSHI.

- Pika 2 dhe 2/1 – Jepen të dhënat e plota të drejtuesit të projektit.
- Pika 3 - Bëhet identifikimi i problemit dhe argumentohet rëndësia e zgjidhjes së tij. Në këtë kuadër duhet të sqarohen çështje të tilla si:
 - ◆ gjendja e deritanishme ose njohja e problemit para ndërmarrjes së projektit;
 - ◆ arsyet përse ndërmerret projekti dhe çfarë synohet të zgjidhet në kuadër të tij;
 - ◆ alternativat e zgjidhjes së problemit;
 - ◆ të rejtat që pritet të sjellë projekti në planin shkencor dhe/ose teknologjik;
 - ◆ ndikimi ekonomik, social, ekologjik, etj., i zgjidhjes së problemit;
 - ◆ a janë të komercializueshme rezultatet e pritshme të projektit;
 - ◆ a është e domosdoshme që projekti të ndërmerret në këtë moment;
 - ◆ përveç institucionit që ndërmerret studimin, kujt tjetër i interesojnë rezultatet e pritshme të projektit për zbatim;
 - ◆ përse projekti duhet të financohet nga buxheti i shtetit, etj..
 - ◆ Jepen punimet shkencore të kryera deri tani në këtë fushë ose që janë në proces nga institucione të tjera shkencore brenda ose jashtë kuadrit të PKKZH, si dhe lidhja që ato kanë me projektin që do të ndërmerret, me qëllim që të shmanget përsëritja ose kryerja e punëve paralele.
 - ◆ Jepen punimet shkencore të kryera ose që janë në proces në këtë fushë nga njësi të tjera (grupe kërkimore, sektorë, etj.) në vetë Agjencinë Ekzekutuese brenda ose jashtë kuadrit të PKKZH, që kanë lidhje me projektin që do të realizohet, me qëllim që të shmangen paralelizmat dhe njëkohësisht të shfrytëzohen rezultatet e tyre.

- Pika 4 - Jepet qëllimi dhe Objektivat e projektit. Jepet *objektivi i zhvillimit* të projektit, që shpreh një pikësynim të rëndësishëm në lidhje me zhvillimin e kërkimeve në fushën përkatëse, sipas formulimit të bërë në Programin Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim.

Jepen *objektivat imediate* që përbëjnë synimet thelbësore të projektit. Ato duhet të formulohen si qëllime, të jenë të shprehura në mënyrë konçize dhe të saktë, duke vënë në dukje progresin që do të arrihet në krahasim me gjendjen para projektit. Duhet të mënjanoen objektivat imediate me karakter të përgjithshëm. Objektivat imediate duhet të jenë konkrete. Arritja e tyre duhet të shprehet me rezultate të matshme e të kontrollueshme, që mund të arrihen me aktivitete brenda mundësive të financimit, kohës, forcave njerëzore e materiale të disponueshme. Për çdo objektiv imediat të jepen rezultatet e pritshme që justifikojnë arritjen e tij. Çdo objektiv mund të ketë një ose disa rezultate. Pasqyrohet raporti i objektivave imediate dhe i rezultateve të pritshme të projektit me ato të projekteve të tjera të kësaj fushe që zhvillohen në institucionet e përfshira në projekt ose jashtë tyre.

- Pika 5 – Jepen aktivitetet e projektit të lidhura me objektivat e projektit
- Pika 6 – Përshkruhet metodologjia e realizimit të projektit.
- Pika 7 – Jepen rezultatet e projektit të lidhura me objektivat dhe aktivitetet dhe si do t’iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre. Rezultati/et duhet të shprehet me terma të qarta e të jetë i matshëm.
- Pika 8 – Jepen përfituesit direkt dhe indirekt nga projekti.
Duhet të përshkruhet në mënyrë specifike cilët janë përfituesit direktë të produktit të kërkimit shkencor e lidhur me fushën strategjike ku aplikohet.
- Pika 9 – Jepet personeli që do të përfshihet në projekt. Në personelin e projektit përfshihen bashkëpunëtorët shkencorë, pedagogë dhe pozicione pune si prsh., ekonomist, laborant, IT, jurist etj. Në grupin e punës të projektit nuk duhet të përfshihen persona që janë ekspertë të komisioneve të vlerësimit të projekteve në AKKSHI.
- Pika 10 – Jepet plani i punës për realizimin e projektit.

Forma e Propozimit Financiar

Në **Formën e Propozimit Financiar** paraqitet ndarja e fondeve (shpenzimeve) në mënyrë të detajuar sipas zërave të tabelës.

*Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen sipas ligjeve të buxhetit të shtetit.

*Pagesat e personelit, duhet t’i referohen kontratës të punës që çdo anëtar i projektit ka në IAL ose në institucionin që aplikon për projektin.

Në zërin “Udhëtime dhe dieta”, aplikanti do të duhet të argumentojë udhëtimet në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të Projektit. Gjatë implementimit të projektit, shpenzimet e udhëtimit do të justifikohen me dokumentat përkatëse. Shpenzimet për udhëtime, dieta, akomodim, do të bëhen sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar. *Nuk lejohen udhëtimet jashtë vendit.

Shpenzimet për karburantit do të justifikohen me distancën në km të levizjes së skuadres së projektit.

Në zërin “Publikime”, aplikanti duhet të vendosë logon e AKKSHI-së në të gjithë informacionin lidhur me publikimet, aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të AKKSHI-së, si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte të përgatitura në kuadër të projektit.

SHËNIM:

Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit.

Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, nuk duhet të lidhen me funksionimin e përgjithshëm të institucionit dhe duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:

- a. Blerje e tokës.
- b. Shit-blerje makinash.
- c. Interes mbi huadhënie.
- d. Marrëveshje huadhënie.
- e. Dhurime.
- f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
- g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.
- h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolona “Përshkrim i detajuar”, duhet të jetë e plotësuar për të gjitha shpenzimet.